



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.152/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.01.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.152/2025 e datës 23.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se më 23 janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Prishtinë ka identifikuar banerët/posterët të vendosur në rrugën hapësirat/ objektet/ rrugët publike të kandidatit për deputet nga radhët e LDK-së Florian Dushi, në rrugën "Ilaz Kodra", në "Kurriz" në Prishtinë.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose*

jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.” Tutje parashtruesi i ankesës thekson se përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP-së, mes tjerash me vendimet Anr.48/2025, Anr.49/2025, Anr.50/2025, Anr.51/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 25.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 25.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka kundërshtuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me pretendimin se për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës ekziston Vendimi i Komunës së Prishtinës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike ku miratohet kërkesa për shfrytëzim të hapësirës publike, respektivisht i lejohet vendosja e dy banerave në ballinë të mbikalimit në rr “Ilaz Kodra”. Raste precedentë ku PZAP ka refuzuar ankesat e njëjta të subjektit politik LVV keni vendimet Anr.93/2025 dhe 95/2025. Tutje përmes përgjigjes në ankesë subjekti politik LDK ka kërkuar nga PZAP që të marr vendim meritore për rastin në fjalë dhe duke u bazuar në krejt ato që u thanë dhe provat e bashkangjitura ka kërkuar që ankesa e subjektit politik LVV të refuzohet si e pabazuar.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur Vendimin e Komunës së Prishtinës – Drejtorisë së Shërbimeve Publike ku miratohet kërkesa për shfrytëzim të hapësirës publike, rekspektivisht i lejohet vendosja e dy banerave në balline të mbikalimit në rr “Ilaz Kodra”.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara.

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast Vendimin me nr. të Referencës 07-353/02-8569 datë 16.01.20205 e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, në cilën vendim ndër të tjera thuhet se “*Miratohet kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike lejes për vendosjen e dy Banereve ne balline të mbikalimit ne rr ‘Ilaz Kodra’ që lidh Dardanin me Posten me sipërfaqe prej 7.20 metër katror (3.00x1.20) shfrytëzuesit për fushatë zgjedhore për deputet të Kosovës Florian Dushit etj nga në Prishtinë në bazë të skicës së vërtetuar nga Drejtoria përgjatë periudhës në kohëzgjatje prej datës 22.01.2025 deri më 10.02.2025*”, konstatoi se subjekti

Politik LDK, ka pëlqim nga Komuna e Prishtinës për vendosjen dy banerave në rrugën Drenica nga data 22.01.2025 deri më 10.02.2025.

Në nenin 5 par.1.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, në mënyrë decisive thuhet se *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Ndërsa në nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.152/2025 datë 25.01.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.18/2025


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Ragip Namani dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më dt.9.02.2025, të paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.152/2025 dhe A.nr.156/2025 dt.25.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 1.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.152/2025 dhe A.nr.156/2025 të dt. 25.01.2025.

A r s y e t i m

Me dispozitivin e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.152/2025 dhe A.nr.156/2025 të dt.25.01.2025, janë refuzuar si të pabazuara ankesat A.nr.152/2025 e dt.23.01.2025 dhe A.nr.156/2025 dt.23.01.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më dt.9.02.2025.

Kundër vendimeve të sipërpërmendura të PZAP, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me kohë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilës konteston ligjshmërinë e vendimeve të sipër cekura, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohen vendimet i sipër përmendura të PZAP-së, të urdhërojë PZAP-në, që ti shqiptojë sanksionin me gjobë Subjektit Politik LDK bashkë me masat përmirësuese sipas legjislacionit zgjedhor.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:


Ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 23.01.2025 ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se më dt.23.01.2025, në Prishtinë, ka identifikuar banerët / posterët të vendosur në rrugën hapësirat/ objektet/ rrugët publike të kandidatit për deputet nga radhët e LDK-së Florian Dushi, në rrugën “Ilaz Kodra”, në kurriz, në Prishtinë, përkatësisht, se më dt.22.01.2025, konkretisht në rrugën “Drenica”, në lagjen “Kodra e Trimave”, Prishtinë, ka identifikuar flamuj të LDK-së të vendosur në varg përmbi rrugën e lartë përmendur, me qëllim të ndikimit në votues dhe përfitimit të votave, në kundërshtim me dispozitat ligjore, zgjedhore i cili veprim është në kundërshtim me nenin 34 par 1, nën p.1.2 të LZP-së, duke bashkangjitur për këtë një fotografi për të dëshmuar vendosjen e flamujve dhe shenjave zgjedhore. Më datën 24.01.2025, PZAP-i e njoftoi Subjektin Politik LDK, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i kërkuar edhe përgjigjen në ankesë. Nëpërmjet përgjigjes në ankesë, dt.25.01.2025, Subjekti Politik LDK, ka kundërshtuar ankesat e paraqitura nga Subjekti Politik LVV, me pretendimin se për Subjektin Politik LDK, ekziston Vendimi i Komunës së Prishtinës, Drejtorisë



së Shërbimeve Publike ku miratohet kërkesa për shfrytëzim të hapësirës publike, respektivisht lejohet vendosja e banerëve në ballinë të mbikalimit në rr “Ilaz Kodra”, përkatësisht, se nuk qëndron pretendimi i LVV, për shkeljen e nenit 34 par.1, nënp.1.2 të LZP-së, sepse vendosja edhe e materialeve reklamuese në këtë rast flamujve përmbi rrugën e lartë cekur, janë veprime në pajtim me legjislacionin në fuqi i cili rregullon mënyrën se si Subjektet Politike duhet të veprojnë, nga se Subjekti Politik LDK, ka marrë pëlqimin nga organi kompetent për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, e që një veprim të tillë e arsyeton edhe Rregullorja Zgjedhore, konkretisht neni 5 par.1, nënp.1.2, dhe si provë ka bashkangjitur Pëlqimin për vendosjen e Flamujve me simbol të LDK, në rrugën “Drenica” etj.

Në arsyetimin e vendimit të tij, PZAP-i, theksoi se pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik LDK, gjeti se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi si të pa bazuara. Kështu sepse, parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes nga neni 34 par.1, nënp.1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo, Paneli në bazë të shkresave të lëndës të bashkangjitura në përgjigje të ankesës, në këtë rast Vendimin me nr. të ref.07-353/02-8569 dt.16.01.2025, përkatësisht, nr.ref.07-353/02-13052/25 dt.20.01.2025, të lëshuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, në të cilat vendime ndër të tjera thuhet se “ Miratohet kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike lejes për vendosjen e dy banerëve në ballin e mbikalimit në rr “Ilaz Kodra” që lidh Dardaninë me Posten me sipërfaqe prej 7.20 m2 (30.00 x 1.20) shfrytëzuesit për fushatë zgjedhore për deputet të Kosovës Florian Dushi etj, nga Prishtina në bazë të skicës së vërtetuar nga Drejtoria përgjatë periudhës në kohëzgjatje prej datës 22.01.2025 deri më 10.02.2025”, respektivisht, ka pëlqim “Për vendosjen e Flamujve me simbol të Partisë LDK, në rrugën “Drenica”, Flamujt lejohet të qëndrojnë nga dt.21.01.2025 deri më 9.02.2025” dhe konstatoi se Subjekti Politik LDK, ka pëlqim nga Komuna e Prishtinës, për vendosjen e Banerëve, përkatësisht, Flamujve, ashtu siç u përshkrua më lartë. Me nenin 5 nënp.1.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, në mënyrë decitive thuhet se “ të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”. Ndërsa, në nenin 34 par.1, nënp.1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, thuhet se “Vendosja e njoftimeve, pllakatave dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore



brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen pronarëve ose shfrytëzuesve”. Ndaj, nga arsyet e sipër cekura, PZAP-i, ka konstatuar se pretendimet për shkeljet e sipër përmendura janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin sepse, nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës, nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartë cekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me shkeljet e pretenduara të Subjektit Politik LVV, të përshkruara më sipër, me që vendimi i të njëjtit organ nuk është i kundërligjshëm, është i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, në dispozitat e sipër cituara ligjore. Vendimi i PZAP-së, është marrë pasi që më parë, në mënyrë të sigurt është vërtetuar se në rastin konkret juridik nga ana e Subjektit Politik LDK, nuk ka shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ndaj, në kuptim të dispozitës së nenit 117 par.3, etj, të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të sipër përmendur.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, shkeljet e dispozitave përkatëse të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, etj, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, veç tjerash, PZAP, përkitazi me këtë rast, ka vlerësuar të gjitha provat e administruara dhe shkresat e lëndës, veçanërisht, Vendimin e sipër përmendur të organit kompetent të Komunës së Prishtinës, përkitazi me dhënien e lejes – pëlqimit përkatës subjektit Politik LDK-së, me të dhënat tjera, si në shkresat e lëndës, nga të cilat ka rezultuar se në rastin konkret nuk qëndrojnë shkeljet e pretenduara nga Subjekti Politik LVV.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën



e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër vendimeve të kontestuara, e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura, e në pajtim me dispozitat e nenit 118 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.18/2025 dt. 1.02.2025

Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SHIDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-18/2025
Oznaka spisa: 0A-02-202X

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

P 2-A P

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendur në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsesës, fqijt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribrano na vrstima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ ças.
dana _____ u _____

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

(Të panevojshmeve bëri vizë - nepotrebnje precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

Numri i shtojave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lanëpërmendur
më (me fjalë)
Povrđujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është gjetur gjatë gjatë kohës që nuk është në gjendje të nënshkruajë
dokumentin, duke shkruar shkaktuesin ose marrësin në një letër të nënshkruar me dorë të marrësit.
Ako je primilac neprimen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc.
Napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.